



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost  
Kosovo Academy for Public Safety

Me datë: 28.10.2016

## **Akademia e Kosovës për Siguri Publike**

### **SHPALL KONKURS**

Për angazhim me honorar të personelit akademik në Fakultetin e Sigurisë Publike, për vitin akademik 2016/2017

#### **I. Drejtimi: Policia dhe Inspektorati Policor**

Nr.	Lëndët	Semestri
1.	Menaxhimi i Trafikut	dimëror
2.	Krimet Financiare	veror

#### **II. Drejtimi: Doganor**

Nr.	Lëndët	Semestri
1.	Zbatimi i Politikës Fiskale në Dogana	dimëror
2.	Menaxhmenti dhe Liderhipi në Dogana	veror
3.	Vlera Doganore e Mallrave	veror
4.	Kontrolli Doganor	veror
5.	Kontrolli i trafikut rrugor	veror
6.	Kontrolli i trafikut ajror dhe pasagjereve	veror

Lëndët me numër rendor 5 dhe 6 janë lëndë zgjedhore, andaj kontrata do të lidhet me mësimdhënësin vetëm nëse lënda zgjidhet nga studentet.

**Konkursi është intern (brendshëm) andaj të drejtë aplikimi kanë vetëm zyrtaret e punësuar në Policinë e Kosovës, Inspektoratin e Policisë së Kosovës dhe Doganën e Kosovës.**

**Zyrtaret e Institucioneve të lartcekura, mund të aplikojnë vetëm në lëndën/lëndët nga drejtimi sipas institucionit punëdhënës, shembull: për lëndët nga drejtimi Policia dhe Inspektorati Policor mund të aplikojnë vetëm zyrtaret e Policisë dhe Inspektoratit Policor të Kosovës të cilët plotësojnë kriteret e konkursit.**

Kandidatet e interesuar duhet të kenë gradë shkencore se paku master/magjistraturë apo ekuivalent dhe përvojë profesionale në fushën e lëndës që aplikon.

Përzgjedhja e personelit të angazhuar do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Kompensimi për personelin e angazhuar (me honorar) do të bëhet vetëm për orët e mbajtura, në përputhje me dispozitat e Rregullores (QRK) – Nr.25/2013 për Pagesat e personelit Trajnues dhe Mësimdhënës si dhe Eksperteve të fushave Funksionale.

Kandidatet që paraqiten në konkurs duhet të dorëzojnë:

- Kërkesën për aplikim (të specifikohet lënda për cilën aplikon);
- Një cv profesionale;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kontratën e punës dhe një vërtetim se i njëjti ende është në marrëdhënie pune në Institucionin e Sigurisë.
- Kopjen e diplomës, të studimeve themelore, master/magjistraturë dhe doktoratës (të noterizuara);
- Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale;
- Vendimin për nostrifikimin e diplomës (kandidatet që kanë mbaruar studimet jashtë vendit).
- Si dhe informata tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme për aplikantin.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në Vushtrri, Ndërtesa e Administratës, Zyra e Personelit nr.01.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Konkursi mbetet i hapur **7 ditë** kalendarike nga dita e shpalljes, respektivisht deri me datën **03.11.2016**, në ora 16:00.

Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve, do të njoftohen vetëm kandidatet e përzgjedhur për angazhim me honorar.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Divizionin për Burime Njerëzore, në numrin e tel: 028 590 070 Ext 210, prej orës 08:00 - 1600.